

The School District of Philadelphia
(Rajoni Shkollor i Filadelfias)
Office of Student Rights & Responsibilities
(Zyra e të Drejtave dhe Përgjegjësive të Nxënësve)
440 N. Broad Street, Second Floor
Philadelphia, PA 19130
Zyra: 215.400.4830 ~ Faksi: 215.400.4226

Rachel Holzman, Esquire
Zëvendës Shefe

Njoftimi i të drejtave sipas FERPA-s (Aktit për Privatësinë dhe të Drejtat Arsimore të Familjeve) për shkollat fillore dhe të mesme

“Akti për Privatësinë dhe të Drejtat Arsimore të Familjeve” (FERPA) u jep prindërve dhe nxënësve të cilët janë 18 vjeç e lart (“nxënësve të kualifikuar”) disa të drejta të veçanta në lidhje me dokumentacionin arsimor të nxënësit. Këto të drejta janë:

1. E drejta për të inspektuar dhe rishikuar dokumentacionin arsimor të nxënësit brenda 45 ditësh pas ditës kur shkolla merr kërkesën për qasje.

Nxënësit e kualifikuar ose prindërit që dëshirojnë të inspektojnë dokumentacionin e tyre arsimor ose të fëmijës së tyre duhet t'i japin drejtorit të shkollës një kërkesë me shkrim e cila identifikon dokumentacionin që ata duan të inspektojnë. Zyrtari i shkollës do të organizojë qasjen dhe do të njoftojë prindin ose nxënësin e kualifikuar për orën dhe vendin ku mund të inspektohet dokumentacioni.

2. E drejta për të kërkuar ndryshimin e dokumentacionit arsimor të nxënësit për të cilin prindi ose nxënësi i kualifikuar mendon se është i pasaktë, mashtrues ose përndryshe që shkel të drejtat e privatësisë të nxënësit sipas FERPA-s.

Nxënësit e kualifikuar ose prindërit të cilët dëshirojnë t'i kërkojnë shkollës që të ndryshojë dokumentacionin e tyre arsimor ose të fëmijës së tyre duhet të kontaktojnë drejtorin e shkollës ose zyrtarin e posaçëm të shkollës, të identifikojnë me qartësi pjesën e dokumentacionit që duan të ndryshojnë dhe të specifikojnë se pse duhet ndryshuar. Nëse shkolla vendos që të mos e ndryshojë dokumentacionin sipas kërkesës së prindit ose nxënësit të kualifikuar, shkolla do të njoftojë prindin ose nxënësin e kualifikuar për vendimin dhe të drejtën e tyre për një seancë dëgjimore në lidhje me kërkesën për ndryshim. Informacion shtesë në lidhje me procedurat e seancës dëgjimore do t'i jepen prindit ose nxënësit të kualifikuar kur të njoftohen për të drejtën për seancë dëgjimore.

3. E drejta për të dhënë miratim me shkrim para se shkolla të nxjerrë informacion personal identifikues (PII) nga dokumentacioni arsimor i nxënësit, përveçse në atë masë në të cilën FERPA autorizon nxjerrjen pa miratim.

Një përjashtim, i cili lejon nxjerrjen pa miratim, është nxjerrja për zyrtarët e shkollës me interesa arsimore të ligjshme. Kriteret që përcaktojnë se kush përbën një zyrtar të shkollës dhe çfarë përbën një interes arsimor të ligjshëm duhet të parashtrihen në njoftimin vjetor të shkollës ose të rajonit shkollor në lidhje me të drejtat FERPA. Zyrtari i shkollës zakonisht përfshin një person të punësuar nga shkolla ose rajoni shkollor si administrator, përgjegjës, instruktor ose anëtar i stafit mbështetës (duke përfshirë stafin mjekësor ose shëndetësor

dhe personelin e njësisë të forcave të zbatimit të ligjit) ose një person që shërben në bordin e shkollës. Zyrtari i shkollës mund të përfshijë gjithashtu një vullnetar, kontraktor ose konsulent i cili, ndonëse nuk është i punësuar nga shkolla, kryen një shërbim ose funksion institucional për të cilin shkolla përndryshe do të përdorte punonjësit e saj dhe i cili është nën kontrollin direkt të shkollës në lidhje me përdorimin dhe mirëmbajtjen e PII-së nga dokumentacioni arsimor, i tillë si një avokat, auditor, konsulent mjekësor ose terapist; një prind ose nxënës që del vullnetar për të shërbyer në një komitet zyrtar, i tillë si një komitet disiplinor ose ankesash; ose një prind, nxënës ose vullnetar tjetër i cili ndihmon një zyrtar tjetër të shkollës për të kryer detyrat e tij ose të saj. Zyrtari i shkollës zakonisht ka interes arsimor të ligjshëm nëse ka nevojë të rishikojë dokumentacionin shkollor për të përmbushur përgjegjësinë e tij ose të saj profesionale.

Sipas kërkesës, shkolla nxjerr pa miratim dokumentacionin arsimor për zyrtarët e një shkolle ose rajoni tjetër shkollor në të cilin nxënësi kërkon ose synon të regjistrohet ose është tashmë i regjistruar nëse nxjerrja ka për qëllim regjistrimin ose transferimin e nxënësit.

E drejta për të bërë ankesë te Departamenti Amerikan i Arsimit në lidhje me supozimet se rajoni shkollor nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e FERPA-s. Emri dhe adresa e zyrës që administron FERPA-n janë:

Family Policy Compliance Office
(Zyra e Pajtueshmërisë për Politikën e Familjeve)
U.S. Department of Education
(Departamenti Amerikan i Arsimit)
400 Maryland Avenue, SW
Washington, DC 20202

FERPA lejon nxjerrjen e PII-së nga dokumentacioni arsimor i nxënësit, pa miratim nga prindi ose nxënësi i kualifikuar, në qoftë se nxjerrja plotëson disa kushte të caktuara të cilat gjenden në paragrafin 99.31 të rregullores FERPA. Përveç nxjerrjeve për zyrtarët e shkollës, nxjerrjet që kanë të bëjnë me disa urdhra gjyqësorë ose thirrje të ligjshme në gjykatë, nxjerrje të informacionit të regjistrit dhe nxjerrje për prindin ose nxënësin e kualifikuar, paragrafi 99.32 i rregullores FERPA kërkon që shkolla ta regjistrojë nxjerrjen. Prindërit dhe nxënësit e kualifikuar kanë të drejtë që të inspektojnë dhe rishikojnë dokumentacionin e nxjerrjeve të bëra. Shkolla mund të nxjerrë PII nga dokumentacioni arsimor in nxënësit pa marrë miratim paraprak me shkrim të prindërve ose nxënësit të kualifikuar -

- Për zyrtarë të tjerë të shkollës, duke përfshirë mësuesit, brenda për brenda institucionit ose agjencisë për të cilën shkolla ka vendosur se ka interesa arsimore të ligjshme. Kjo përfshin kontraktorë, konsulentë, vullnetarë ose palë të tjera të cilët shkolla mbështetet për funksione ose shërbime institucionale, me kusht që të plotësohen kushtet e shënuara në paragrafin 99.31(a)(1)(i)(B)(1) – (a)(1)(i)(B)(3). (Paragrafi 99.31(a)(1))
- Për zyrtarë të një shkolle, sistemi shkollor ose institucioni tjetër të arsimit pas shkollës së mesme ku nxënësi kërkon ose synon të regjistrohet ose ku nxënësi është tashmë i regjistruar në qoftë se nxjerrja shërben për regjistrimin ose transferimin e nxënësit sipas kërkesave të paragrafit 99.34. (Paragrafi 99.31(a)(2))
- Për përfaqësuesit e autorizuar të Kontrollorit të Përgjithshëm Amerikan, Prokurorit të Përgjithshëm Amerikan, Sekretarit Amerikan të Arsimit, ose autoritetet arsimore lokale ose shtetërore, të tilla si Agjencia Arsimore e Shtetit (SEA) në shtetin e prindit ose nxënësit të kualifikuar. Në përputhje me paragrafin 99.35, nxjerrjet sipas kësaj klauzole mund të bëhen në lidhje me një auditim ose vlerësim të programeve arsimore federale ose të mbështetura

nga shteti, ose për zbatimin apo përputhshmërinë me kërkesat ligjore federale të lidhura me këto programe. Këto subjekte mund të bëjnë nxjerrje të mëtejshme të PII-së për subjekte të jashtme të caktuara prej tyre si përfaqësuesit e tyre të autorizuar për të kryer auditim, vlerësim ose aktivitet zbatimi apo përputhshmërie në emër të tyre, në qoftë se plotësohen kërkesat përkatëse. (Paragrafi 99.31(a)(3) dhe 99.35)

- Në lidhje me ndihmën financiare për të cilën nxënësi ka aplikuar, të cilën nxënësi e ka marrë, në qoftë se informacioni është i nevojshëm me qëllim që të vendoset kualifikimi për ndihmën, shuma e ndihmës, kushtet e ndihmës ose për të zbatuar kushtet dhe konditat e ndihmës. (Paragrafi 99.31(a)(4))
- Për autoritetet ose zyrtarët lokalë ose shtetërorë të cilëve u lejohet në mënyrë specifike që t'u raportohet ose nxirret informacioni sipas një statuti shtetëror i cili ka të bëjë me sistemin e drejtësisë për të rinjtë dhe aftësinë e sistemit për t'i shërbyer në mënyrë të efektshme nxënësit, para vendimit, dokumentacioni i të cilit u nxorr sipas paragrafit 99.38. (Paragrafi 99.31(a)(5))
- Për organizatat që kryejnë studime për, ose në emër të shkollës: (a) për të zhvilluar, konfirmuar ose kryer provime parashikuese; (b) për të administruar programe ndihme për nxënësit; ose (c) për të përmirësuar mësimdhënien, nëse plotësohen kërkesat përkatëse. (Paragrafi 99.31(a)(6))
- Për organizatat e akreditimit për të kryer funksionet e tyre akredituese. (Paragrafi 99.31(a)(7))
- Për prindërit e një nxënësi të kualifikuar në qoftë se nxënësi është i ndërruar për arsye të taksave IRA (Llogari Individuale Pensioni). (Paragrafi 99.31(a)(8))
- Për të përmbushur një urdhër gjyqësor ose thirrje të ligjshme në gjykatë në qoftë se plotësohen kërkesat përkatëse. (Paragrafi 99.31(a)(9))
- Për të caktuar zyrtarë në lidhje me një emergjencë sigurie ose shëndetësore, sipas paragrafit 99.36. (Paragrafi 99.31(a)(10))
- Informacion të cilin shkolla e ka caktuar si "informacion të regjistrit" në qoftë se plotësohen kërkesat përkatëse sipas paragrafit 99.37. (Paragrafi 99.31(a)(11))
- Për një punonjës çështjeje të një agjencie ose përfaqësues tjetër të agjencisë lokale ose shtetërore për asistencën ndaj fëmijëve ose të një organizate fisnore e cila është e autorizuar të ketë qasje në planin e çështjes së nxënësit kur një agjenci ose organizatë e tillë ka përgjegjësi ligjore, sipas ligjit fisnor ose shtetëror, që të kujdeset ose mbrojë nxënësin i cili është vendosur nën kujdestari prindërore. (20 U.S.C. paragrafi 1232g(b)(1)(L))
- Për Sekretarin e Agrikulturës ose përfaqësues të autorizuar të Shërbimit Ushqimor dhe të Ushqyeshmërisë me qëllim kryerjen e monitorimit të programeve, vlerësimeve dhe matjeve të ecurisë së programeve të autorizuara nga Akti Kombëtar "Richard B. Russell" për Drekat në Shkollë ose Akti i Ushqyeshmërisë për Fëmijët i vitit 1996, sipas kushteve të caktuara. (20 U.S.C. paragrafi 1232g(b)(1)(K))